



KOMUNA-SHTIME/OPŠTINA-ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME
DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE/UPRAVA ZA
ZDRAVSTVA I SOCIALNU ZASTITU/DEPARTMENT OF HEALTH AND SOCIAL
WELFARE

Nr: 07/ 85

Datë: 02.07.2021

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, në bazë të Rregullores MF - NR – 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve , neni 2, pika 5, neni 12, neni 13, shpall:

THIRRJE PUBLIKE PËR APLIKIM

MBËSHTETJE FINANCIARE ME SUBVENCIONE PËR OJQ – të DHE SHOQATAT QË
ZHVILLOJNË AKTIVITETE NË FUSHËN E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES
SOCIALE

Qëllimi i Thirrjes për Aplikim është dhënia e mbështetjes financiare me subvencione për OJQ-të dhe Shoqatat, për zbatimin e projekteve për:

1. zhvillimin e aktiviteteve avokuese, këshilluese, rehabilituese dhe ofrimin e drejtpërdrejtë të shërbimeve sociale dhe familjare.
2. Fushatë e vetëdijësimit për shëndetin publik

Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ të dhe Shoqatat që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo qeveritare në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në komunën e Shtimes.

OJQ-të dhe Shoqatat të cilat aplikojnë me projekt propozime , duhet të përcaktohen vetëm në një pikë.

Projektet të cilat do të marrin përkrahje financiare duhet të kenë për objektiv zbatimin e aktiviteteve të ndryshme për mbështetjen e grupeve në nevojë dhe ofrimin e këtyre shërbimeve sociale ,familjare, avokuese,këshilluese dhe edukative të përshkruara si më poshtë:

- a) Shërbime mbështetëse, dhe këshilluese për të gjitha kategorit: e personave me aftësi të kufizuara;
- b) Shërbime mbështetëse dhe këshilluese dhe rehabilituese për Familjet e Dëshmorëve;
- c) Shërbime mbështetëse dhe këshilluese për Veteranët e UÇK-së;
- d) Shërbime mbështetëse , këshilluese, e rehabilituese për invalidët e UÇK –së;
- dh) Shërbime mbështetëse , sensibilizim dhe pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme rekreative për pensionistë dhe persona të moshuar
- d) Shërbime mbështetëse,dhe strehim për viktimat e dhunës familjare.
- e) Shërbime avokuese për të rinjtë për shmangie të sjelljeve devijante dhe dukurive negative me qëllim të formimit të mirfilltë të personalitetit të tyre intelektual;
- f) Shërbime avokuese për të rinjtë për shmangie të sjelljeve devijante dhe dukurive negative me qëllim të formimit të mirfilltë të personalitetit të tyre intelektual;
- g) Fushatë e vetëdijësimit për shëndetin publik

Kriteret dhe dokumentet për aplikim

OJQ-të dhe Shoqatat të cilat kërkojnë mbështetje me subvencione duhet të jenë të regjistruara sipas legjislacionit në fuqi, në Republikën e Kosovës.

OJQ-të dhe Shoqatat duhet të ofrojnë dëshmi për projektet e realizuara në të kaluarën dhe kapacitete të mjaftueshme për zhvillimin e aktiviteteve në fushën e mirëqenies sociale dhe ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare.

Në projekt duhet specifikuar qartë qëllimi, objektivat, aktiviteti, përfituesit dhe buxheti. Përshkrimi i kapaciteteve menaxhuese të organizatës, personeli dhe përfshirja e ekspertëve në zbatimin e projektit.

Dokumentet e nevojshme për aplikim

1. Kopja e letërnjoftimit të Drejtorit (Kryetarit) Ekzekutiv të OJQ-së apo Shoqatës;
2. Projektpropozimi;
3. Tabela e buxhetit të projektit;
4. Kopja e certifikates së regjistrimit të OJQ-së apo Shoqatës;
5. Kopja e certifikates së numrit fiscal;
6. Kopja e xhirollogarisë së OJQ-së apo Shoqatës;
7. Kopja e Statutit të themelimit të OJQ-së apo Shoqatës;
8. Kopja e licencës për OJQ-të dhe Shoqatat e licencuara nga MPMS-ja;
9. CV-të e stafit të angazhuar në zbatimin e projektit;
10. Përparesi kanë OJQ-të dhe Shoqatat të cilat janë të licencuara për ofrimin e shërbimeve sociale;

Afati dhe procedura e aplikimit:

Afati për dorëzimin e Projekt propozimeve për mbështetje me subvencione është 15 ditë nga dita e shpalljes. 02.07.2021 deri 16.07.2021 ora 16:00 H


Projekt propozimet me dokumentet e bashkangjitura mund të dorzohen me postë ose fizikisht në adresën Rr. "Tahir Sinani" nr.50, 72000 Shtime, Republika e Kosoves ,Objekti i Komunes, zyra pritëse, Kati I ,sporteli Nr 3, çdo ditë pune nga ora 8:00-16.

Formularin për aplikim dhe informatat më të hollësishme rreth aplikimit mund të shkarkoni në Web faqen e internetit të Komunës së Shtimes, si dhe mund t'i merrni në Zyrën e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar Brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike dhe të cilat I përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.



Drejtori



Musë Baftiu